



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
DREJTORIA E KULTURËS,SPORTIT,TURIZMIT DHE ARSIMIT

Nr 1079/11 Prot.

Divjakë më 12 / 02 / 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr 14 Datë 12 / 02 / 2025

“PËR VLERËSIMIN ME TITULL NDERI “ PËR REZISTENCË DHE DINJITET NJERËZOR TË ISH-TË PËRNDJEKURIT Z. LEKË TASI, SI PERSON AKTIV NË DOKUMENTIMIN E SË SHKUARËS”

Mbështetur në ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015,“ Për Vetëqeverisjen Vendore “, neni 54, gërma (m), në Ligjin nr 112/2013 datë 04.04.2013“ Për dekoratat,titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë, neni 3 i ndryshuar me Ligjin nr.94/2022 datë 22.12.2022 “ Për titujt e nderit dhe titujt vendor të nderit, në Republikën e Shqipërisë,si dhe propozimit për titull nderi z. Lekë Tasi, të Drejtorisë së Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, me shkresë nr, 1890 datë 06.11.2024, i propozojmë Këshillit të Bashkisë, që në mbledhjen e datës 24 / 02 / 2025:

1. Të miratojë vlerësimin me Titull nderi: “ Për Rezistencë dhe dinjitet njerëzor të ish-të përndjekurit **Z. Lekë Koço Tasi**, si person aktiv në dokumentimin e së shkuarës”
Me motivacionin: “ *Me nderim të madh, për aktet e tij humane, integritetin njerëzor, angazhimin personal të pakursyer në integrimin e të dënuarve politikë, dokumentimin dhe publikimin e së shkuarës, pjesëmarrjen active në jetën shoqërore, si dhe në përfaqësimin e një shembulli frymëzues të reistencës dhe dinjitetit njerëzor, kundrejt akuzave të padrejta dhe të sajua.*”
2. Për ndjekjen e procedurave të mëtejshme ngarkohet Drejtoria e Kulturës,Sportit,Turizmit dhe Arsimit, Sektori Juridik,Prokurimeve publike dhe menaxhimit të aseteve, pranë Bashkisë Divjakë.

Drejtoria e Kulturës,Sportit,
Turizmit dhe Arsimit,
Drejtori
Laurent Gjeçi

Sektori Juridik,Prokurimeve publike
dhe menaxhimit të aseteve,
Juristi
Andi Bullari

KRYETARI I BASHKISË

Josif Gorrea